



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Praktikë Përkthimi (A-B B-A) II

Ngarkesa: 4 kredite, 40 orë seminare

Viti / Semestri: Viti III , semestri II;

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në ‘‘Përkthim dhe Interpretim’’

Adresa elektronike e titullarit / e pedagogut të lëndës: : orges.selmani@unitir.edu.al;
viktor.ristani@unitir.edu.al;

Kodi i lëndës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Të pajisë studentët me bazat teorike dhe praktike të përkthimit me gojë, përmes zbërthimit të thelluar të teksteve. Të zhvillojë aftësitë e studentëve në analizën gjuhësore të teksteve, duke përfshirë aspektet gramatikore, leksikore dhe stilistike në kontekst funksional. Të nxisë përdorimin e dijeve ndërdisiplinore (stilistikë, leksikologji, gramatikë) për të përmirësuar interpretimin dhe përkthimin me gojë.

Objektivat specifike lëndore :

1. Të aftësojë studentët në identifikimin e niveleve të tekstit për zbërthim në kontekstin e përkthimit me gojë.
2. Të njohë studentët me teknikat dhe strategjitë bazë të përkthimit dhe interpretimit në situata reale.
3. Të mësojë studentët të ndërthurin njohuritë nga fusha të ndryshme gjuhësore në mënyrë funksionale gjatë procesit të përkthimit.

Rezultatet e pritshme:

1. Studentët do të jenë në gjendje të analizojnë dhe zbërthejnë tekste në funksion të përkthimit konsektiv.
2. Do të përdorin teknika përkatëse për interpretim dhe do t'i përshtatin ato sipas stilit funksional të tekstit.
3. Do të demonstrojnë zotërim të njohurive ndërdisiplinore për të përballuar sfidat gjuhësore dhe kulturore në përkthimin me gojë.